

atrc.

QENDRA E TRAJNIMEVE &
BURIMEVE PER AVOKIM

PËRMBAJTJA

Faqe 2

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme shpall rundin vjetor të financimit

Fondi i Vëllezërve Rockefeller përkrah zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë

Ekspozitë nga OJQ për Prishtinën

Faqe 3

Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut promovon transparencën në nivel lokal

Biblioteka e ATRC-së me tituj të rinj

Ta bëjmë Ferizajin qytet më të mirë

Faqe 4

Komunat e Kosovës të reformohen, thonë OJQ-të

Swiss Contact përkrah agrobiznesin dhe turizmin në rajonin e Dukagjinit

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ofron praktikë për studentë

Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: www.advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



THE ADVOCATE

Përkrah komunitetin e OJQ-ve

Vëllimi V • Numri 5 • Qershor 2007

Debate publike të organizuara nga ATRC-ja

Politikanët kosovarë u bëjnë thirrje qytetarëve të ruajnë paqen dhe stabilitetin gjatë procesit të përcaktimit të statusit



Kryeministri, Agim Çeku, u sqaroi më 22 maj qytetarëve të Prishtinës procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës

Përfaqësues të qeverisë lokale dhe asaj qendrore, OJQ-ve, mediave dhe sektorit të biznesit në pesë rajonet e Kosovës kanë pasur mundësi të informohen, shqetësimet e tyre të dëgjohen dhe të bëjnë pyetje për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, gjatë pesë takimeve publike të organizuara nga ATRC-ja në muajin maj.

Takimet rajonale në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjilan dhe Ferizaj kanë pasur për qëllim informimin e mëtejshëm të opinionit për rezultatit e statusit, takime këto të cilat u organizuan pas 29 tryezave të rrumbullakëta të mbajtura në muajt shkurt dhe mars.

Organizatat e shoqërisë ci-

vile dhe qytetarët janë informuar po ashtu edhe për propozimin e Martti Ahtisaarit, të dërguarit të posaçëm të OKB-së për negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Politikanë vendor dhe diplomatë të huaj u kanë bërë thirrje qytetarëve të ruajnë paqen dhe stabilitetin në kohën kur përcaktimi i statusit për të ardhmen e Kosovës është në fazën përfundimtare.

"Kemi bërë kompromise. Propozimi i Ahtisaarit është një balancë i mirë. Ai propozon që Kosova të bëhet shtet", ka deklaruar Kryeministri Agim Çeku në takimin e mbajtur në Prishtinë më 22 maj. Propozimi përmban mekanizma mbrojtës për të drejtat e minoriteteve çofshin ato individuale ose politike, ka shtuar Çeku.

Kryesuesi i Zyrës Britanike në Kosovë, David Blunt, ka thënë se pakoja e Ahtisaarit është rezultat i kompromisit

dhe këndvështrimeve të ndryshme. Sipas tij, pakoja paraqet këndvështrimet e shumicës dhe nevojën për mbrojtje të minoriteteve.

Rezoluta e ardhshme për Kosovën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së; roli i Rusisë në procesin e zgjidhjes së statusit; sfidat e implementimit të pakos së Ahtisaarit dhe funksionaliteti i shtetit të Kosovës; dhe procesi i decentralizimit janë çështjet që shqetësojnë më së tepërmi pjesëmarrësit.



Një qytetare shpreh shqetësim për rezultatit e përcaktimit të statusit të Kosovës

Për propozimin e plotë të statusit, vizitoni www.unosek.org

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ekspozitë nga OJQ për Prishtinën

Artistë të rinj të Prishtinës kanë ekspozuar të dhënat e hulumtuara dhe analizuara për historinë dhe kulturën e Prishtinës në përpjekje për të shtuar vetëdijen dhe pjesëmarrjen e publikut për ambientin urban të qytetit të tyre, gjatë një ekspozite dy javore më 11-25 maj në Muzeun e Kosovës

Ekspozita interaktive, e organizuar nga OJQ-ja "Iniciativat për Zhvillim në Kosovë - IRDK" në kuadër të projektit "Zbulo Prishtinën", ka përfshirë qytetarë në dialogun për marrëdhëniet e tyre me ambientin ku jetojnë, të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e Prishtinës.

Sipas IRDK-së, ekspozita ka synuar nxitjen e qytetarëve në promovimin e zhvillimeve pozitive në qytetin e tyre duke mbledhur përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të komunitetit.

Ekspozita "Zbulo Prishtinën" është përkrahur nga ATRC dhe IREX në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile.



Pjesëmarrësit në ekspozitën "Zbulo Prishtinën" më 11 maj

Për më shumë informata kontaktoni: discoverycenter@gmail.com ose vizitoni: www.discoverycenter.net.

Mundësi financimi për OJQ

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme shpall rundin vjetor të financimit

Organizatave të shoqërisë civile të interesuara për përkrahje financiare për projektet e tyre ftohen të aplikojnë për fondet e Qendrës Palme për vitin 2008

Koordinatori i Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme në Prishtinë, Levent Biçaku, i ka informuar përfaqësuesit e OJQ-ve vendore për programet e Qendrës Palme gjatë dy tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga ATRC-ja më 10 dhe 11 maj në Prishtinë dhe Mitrovicë. Biçaku veçoi objektivat dhe prioritetet e financimit, procedurat e aplikimit, si kurse edhe fondet për Kosovën.

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, organizatë suedeze kjo, ka shpallur në maj rundin vjetor të granteve në kuadër të Programit për Ballkanin Perëndimor, të financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim - Sida.



Gjatë periudhës 2008-2010, Qendra Palme do të fokusohet në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje, dhe aftësinë e organizatave të shoqërisë civile dhe administratave lokale që të përfitojnë dhe marrin pjesë në procesin e zgjerimit të BE-së

"Prioritetet e financimit kanë të bëjnë me demokracinë, të drejtat e njeriut dhe paqen," ka thënë Biçaku.

Ai u bëri thirrje përfaqësuesve të OJQ-ve që të aplikojnë me projekt propozime më të mira sepse "shanset për t'u financuar varen nga kualiteti i propozimeve".

Qendra Palme kontribuon për një botë të lirë, paqësore dhe demokratike, ku respektohen të drejtat e njeriut, ka shtuar Biçaku.

Për informata për fondet e Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe aplikim vizitoni: www.palmecenter.org (shtyp 'Western Balkan program') ose kontaktoni zyrën në Kosovë të Qendrës Palme: levend.bicaku@palmecenter.se.

Fondi i Vëllezërve Rockefeller përkrah zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë

Fondi i Vëllezërve Rockefeller është organizatë filantropike, e cila punon për të promovuar ndryshimet sociale

ATRC-ja ka organizuar dy tryeza të rrumbullakëta ndërmjet OJQ-ve vendore dhe përfaqësuesit të Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF) për Ballkanin Perëndimor, Haki Abazin, më 17 dhe 18 maj në Prishtinë dhe Mitrovicë.

Abazi paraziti programet e granteve të RBF-së të cilat fokusohen në katër fusha: praktikën demokratike; zhvillimin e qëndrueshëm; paqen dhe stabilitetin; dhe avancimin njerëzor.

"Fondi i Vëllezërve Rockefeller është i angazhuar në dhënien e granteve në Kosovë që nga viti 2003. Fondi aktualisht është i përqendruar në dhënien e

granteve në kuadër të dy fushave programore: praktikën demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm", ka deklaruar Abazi.

"Kjo reflekton vlerësimin e RBF-së se ndihma për demokraci tolerante e pluraliste, dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në rajon, paraqet prioritetet kryesore."

Mënyra e aplikimit, procesi i grant dhënies dhe informata shitesë për programet e RBF-së mund të gjinden



Fondi i Vëllezërve Rockefeller organizoi konferencë më 12-14 prill në New York për të ardhmen e Kosovës. Në foto: Presidenti Clinton gjatë adresimit të pjesëmarrësve në konferencë

në www.rbf.org.

Prezantimet e donatorëve janë pjesë e një iniciative të ATRC-së që synon njoftimin e OJQ-ve me mundësitë e financimit dhe donatorët me OJQ-të, të cilat kanë interes të ngjashme.

Planifikimi zhvillimor lokal

Ta bëjmë Ferizajin qytet më të mirë

Përfaqësues të qeverisjes lokale, këshillave joformal, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe ekspertë janë takuar për të diskutuar pjesëmarrjen publike në kontekstin e planifikimit zhvillimor në Ferizaj.

Ata u takuan më 23 maj në kuadër të tryezës së rumbullakët "Shndërrimi i Demokracisë në Qeverisje të Mirë, nga Perspektiva e Planifikimit", të organizuar nga UN Habitat i bashkëpunim me ATRC-në. Pjesëmarrësit përqendruan diskutimin në mënyrat dhe mekanizmat e nxitjes së përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e planifikimit si një ndër parimet e qeverisjes së mirë, dhe komponent esencial i strategjisë së planifikimit zhvillimor lokal.

Ata u pajtuan që idetë e shoqërisë civile të përfshihen në dokumentet planifikuese. Tryeza shërbeu për të këmbyer përvojat ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve të qeverisë lokale në gjetjen e zgjidhjes për angazhim më të madh të shoqërisë civile në proceset e vendim-marrjes.



Ferizaj, Kosovë

Për më shumë informata: kontakti info@unhabitat-kosovo.org

Transparenca dhe informimi publik

Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut promovon transparencën në nivel lokal



Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut monitoron shfrytëzimin e automjeteve zyrtare në 6 komuna

Zyrtarë të Komunës së Prizrenit i kanë përdorur automjetet zyrtare pa ndonjë rregullore/urdhër administrativ, i cili do të autorizonte rregullat dhe qëllimet e shfrytëzimit të automjeteve në Prizren.

Kështu ka qenë deri në mars të këtij viti kur Asambleja Komonale miratoi "Rregulloren për Shfrytëzimin të Automjeteve Zyrtare

në Komunën e Prizrenit", si rezultat i përpjekjeve avokuese të Rrjetit të Radiove për të Drejtat e Njeriut (RDN).

Prizreni nuk është e vetmja komunë ku RDN avokon për transpa-

rencë, por është suksesi më i madh i saj. Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut është duke implementuar projektin "Transparenca dhe e Drejta e Informimit të Publikut për Dokumentet Zyrtare," i cili përfshinë gjashtë komuna të Kosovës: Prishtinën, Fushë Kosovën, Klinën, Mitrovicën, Prizrenin dhe Kamenicën.

Projekti synon avancimin e proceseve të transparencës në nivel lokal përmes mediave për t'iu qasur publikut.

"Ndikimi i RDN-së në punën e Komunës së Prizrenit është tregues real për rolin që mediat mund të luajnë në implementimin e ligjit nga vendim-marrësit në të mirë të qytetarëve", ka thënë Ekrem Qitaku, drejtor i RDN-së.

Tetë radio stacione në rajone të ndryshme të Kosovës përfaqësojnë të gjitha komunitetet etnike janë pjesë e rrjetit: Vala Rinore, Yeni Donem, Contact Plus, Radio Kamenica, Radio Peja, Radio K, Kent Fm dhe Radio Contact.


Për më shumë informata, kontakti: rdnvalarinore@gmail.com

Biblioteka e ATRC-së me tituj të rinj

Njëqind e shtatëdhjetë tituj të rinj i janë shtuar bibliotekës së ATRC-së në muajt prill dhe maj. Në tërësi, biblioteka përmban më shumë se 800 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera për avokim, shoqëri civile, lidhshmëri, vetëdijesim gjinor, të drejta të njeriut, etj.

OJQ-të kosovare dhe ato ndërkombëtare, studentë universiteti, gazetarë, zyrtarë qeveritarë dhe qytetarë të interesuar mund të kenë qasje në bibliotekë.

Ajo përmban publikime dhe materiale trajnimi në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në fushën e menaxhmentit, avokimit dhe lobi-mit, sociale, ekonomike,



Biblioteka e ATRC-së përmban më shumë se 800 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe

politike, ligjore, gjinore, probleme shëndetësore, dhe ambient. Biblioteka përmban po ashtu koleksion interesant të studimeve, ra-

porteve, dhe udhëzuesve për çështje politike, ekonomike, dhe sociale në Kosovë të publikuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.

ATRC-ja do të vazhdojë përsëritjen e bibliotekës me tituj të rinj, kështu institucione dhe organizata të ndryshme janë të mirëseardhura të kontribuojnë me publikimet e tyre duke kontaktuar info@advocacy-center.org ose 038 244 810.

Lexuesit kanë qasje online në databazën e bibliotekës në www.advocacy-center.org (shtyp shërbimet) për të parë listën e plotë me të gjithë titujt.

atrc

Executive Director
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org

Financial & Administration Manager
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org

Grant Manager
TEUTA LUZHA
teuta@advocacy-center.org

Grant Officer
KUSHTRIM KALOSHI
kushtrimk@advocacy-center.org

Grant Officer
XHAFER AHMETI
xhafer@advocacy-center.org

Grant Finance Manager
SAFETA XHEKOVIC
safeta@advocacy-center.org

Training & Consultancy Services Manager
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
AFERDITA SURROI
aferdita@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
KUSHTRIM ISLAMI
kushtrim@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
NORA SUSURI
nora@advocacy-center.org

Communication & Outreach Manager
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org

Program Officer
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

IT and Database Manager
ARSIM KOSUMI
arsim@advocacy-center.org

Shërbimet publike

Komunat e Kosovës të reformohen, thonë OJQ-të

Zyrtarë komunal dhe OJQ-të kanë diskutuar për shërbimet publike të komunave gjatë pesë workshopeve të mbajtura në prill dhe maj në pesë rajonet e Kosovës, të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe përkrahur nga IREX, ATRC, UNDP dhe OSBE.

Këto takime synonin këmbimin e praktikave të mira

në informimin dhe pjesëmarrjen publike, konsultimin dhe mundësitë e barabarta, përcaktimin e kompetencave komunale dhe shtimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave.

"Për qytetarët nuk është e qartë se cilat shërbime i ofron komuna e tyre", ka pohuar Sazan Ibrahim, drejtor i AKK-së, duke iu referuar perceptimit publik

ndaj shërbimeve komunale. Sipas përfaqësuesve të OJQ-ve, qeveria lokale ka nevojë të reformohet.

Rezultati i takimeve do të publikohet në një broshurë, e cila do të shërbejë si udhëzues për implementimin e praktikave më të mira nga komunat e Kosovës.

Për më shumë informata, vizitoni www.komunat-ks.net

Mundësi financimi për OJQ

Swiss Contact përkrah agrobiznesin dhe turizmin në rajonin e Dukagjinit

Zyra e Swiss Contact në Gjakovë ka ftuar në maj OJQ-të kosovare për të aplikuar me projekte në dy fusha: agrobiznes dhe turizëm, në kuadër të Projektit për Zhvillim të Bizneseve të Grave (PZhBG) të financuar nga qeveria zvicrane.

PZhBG synon fuqizimin e grave ekonomikisht për-

mes marketingut dhe zhvillimit të shërbimeve nga furnizuesit lokal për gratë në rajonin e Dukagjinit. Kontributi financiar është maksimum 4.000 € për projekt.

Afati i fundit për aplikim është 11 qershor 2007.

Për informata shtesë dhe formën e aplikimit, kontakti: 0390 24 290



Njoftim

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ofron praktikë për studentë

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), zyra në Kosovë, ofron praktikë për studentë dhe të sapo diplomuarit për periudhën qershor-dhjetor 2007.

Praktikantët do të fitojnë

përvojë të ndryshme gjatë punës në YIHR, të angazhohen në një sërë aktivitësh gjatë kontributit në punët e përgjithshme në zyrë. Përmes punës së tyre, praktikantët do të kenë mundësi të fitojnë njohuri

surojnë dhe praktikojnë njohurinë e fituar gjatë studimeve ose karrierës së tyre profesionale; dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në organizime të ndryshme sikurse edhe të shtojnë kontaktet.

Për përshkrimin e kërkesave të përgjithshme, detyrat dhe përgjegjësitë, kohëzgjatjen e praktikave dhe aplikimin, kontakti: 038 248 509 ose ksoffice@yih.org

